



OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist i Menaxhimit të Sistemit të Matjes**.

SPECIALIST

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Te monitorojë te gjithë aktivitetet e punës në Zonën e Shërbimit që kanë lidhje me Sistemin e Matjes;

Instalimi/Demontimi i matësave;

Zgjidhja e anomalive ne lidhje me sistemin e matjes, të evidentuara gjatë procesit të leximit;

Zgjidhja e çështjeve sipas kërkesës së konsumatorëve;

Testimet periodike të matësave;

Ndërprejet/Rilidhjet e energjise elektrike

E të tjera sipas nevojave;

- Monitoron në kohë reale Grupet dhe Ekipet;
- Koordinon veprimtarinë e matjes dhe proceseve të lidhura me të në tërësi;
- Të adresojë kërkesat për të siguruar funksionimin efikas të Sistemit të matjes;
- Siguron zbatimin e të gjithë Urdhërave të Punës sipas planifikimit në Zonën e Shërbimit;
- Kontrollon veprimtarinë duke siguruar që të gjitha veprimet janë paraqitur konform rregullave procedurale dhe konform rregullave të dokumentacioneve;
- Mirëmban të dhëna mbi aktivitetet e punës;
- Kryen analiza periodike mbi këto të dhëna dhe bashkëvepron me strukturat qendrore për përmirësimin e sistemit të matjes;
- Sigurohet që aktiviteti të realizohet konform rregullave, procedurave dhe udhëzimeve të punës;
- Përcakton prioritetin e detyrave duke siguruar që ato të komunikohen në mënyrën e duhur;
- Mbikqyr situacionimin e bazës materiale në zonën e shërbimit dhe sigurohet që dokumentacioni të jetë në zbatim të procedurave perkatëse;
- Raporton periodikisht tek eprorët e tij të drejtpërdrejtë në Rajon dhe tek Përgjegjësi i Funkcionit në Qendër mbi mbarëvajtjen e të gjithë proceseve;
- Të tjera detyra që Drejtuesi i cakton kohë pas kohe;
- Aktivitete të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.